

# Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton 6 prokurorë të rinj në sistemin e drejtësisë

POSTED 12/07/2019 KLP



Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ditën e sotme, ka miratuar projekt-aktet për verifikim të pasurisë dhe figurës për 6 të diplomuarit e Shkollës së Magjistraturës në 2018 dhe emërimin e tyre si prokurorë, si dhe caktimin në pozicionin e prokurorëve në vendet bosh. KLP-ja më parë ka kërkuar informacione nga institucionet ligjzbatuese për kandidatët, para emërimit të tyre si prokurorë. Më pas vendosi emërimin e tyre në vendet vakante. Ata janë prokurorët: Eliona Elezi, Erida Visoçi, Mediana Meta, Françesk Ganaj, Odeta Todorushi, Albjona Papajani.

Nëpërmjet Komisionit të Karrierës, KLP vendosi themelimin e një metode, e cila do të shoqëroje këtë proces në vite dhe që parashikon: Vetting për kandidatët të cilët emërohen prokurorë për herë të parë në hyrjen e tyre në sistem. Pas kërkesave të kandidatëve, KLP hodhi në votim preferencat e tyre, ndërsa me 11 vota pro vendosi të emërojë këto kandidatë në disa prokurori të vendit.

- Eliona Elezi, emërohet në Prokurorinë e Shkallës së Parë në Krujë
- Erida Visoçi, emërohet në Prokurorinë e Shkallës së Parë në Vlorë
- Mediana Meta, emërohet në Prokurorinë e Shkallës së Parë në Kavajë
- Françesk Ganaj, emërohet në Prokurorinë e Shkallës së Parë në Lezhë
- Odeta Todorushi, emërohet në Prokurorinë e Shkallës së Parë në Korçë
- Albjona Papajani, emërohet në Prokurorinë e Shkallës së Parë në Berat.

KLP ndjen nevojën e adresimit të çështjes për caktimin e përkohshëm të prokurorëve për shkak të mungesës së rregullore për levizjet paralele dhe rregullore për ngritjen në detyrë të prokurorëve. Të dy këto rregullore po punohen aktualisht nga Këshilli në bashkëpunim me misionin ndërkombëtar EURALIUS. Për prokurorët me caktim të përkohshëm me pozicion drejtues, të cilët konkurrojnë për SPAK. ( konkretisht Donika Prela dhe Elizabeta Imeraj ) do të mbeten në këtë gjendje “status quo”-je, deri në finalizimin e procesit të konkurimit për SPAK.